



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Për :	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave -MAPL	
Përmes:	Mirjana Jevtić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së,	
Nga:	Besim Murtezani, U.D. Udhëheqëse i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 14/03/2017 Nr. 020-411
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01Nr.104-5333/17 për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2016.
I miratuar më datë më datë: 28.02.2017
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.03.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Besim Ilazi, gradonačelnik opštine Kačanik Xhelal Gashi, predsedavajući Skupštine opštine Kačanik	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS-u Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini Pravno odeljenje i monitorisanje opština, MALS	
Preko: ZA: BARDHAN GECAD	Mirjana Jevtić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u	
Od:	Besim Murtezani, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum: 14/03/2017 Br.020-411
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Kačanik	
Vrsta akta:	Odluka	

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave dostavljen je sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka 01 br. 104-5333/17 za usvajanje izveštaja rada Odbora za politiku i finansije za 2016. godinu.
Usvojena dana: 28.02.2017.
Dostavljena MALS-u na razmatranje dana: 07.03.2017.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, procenjuje da je isti u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti punopravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave stoji na raspolaganju opštini za bilo kakvo dodatno objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

HYRESE - ULAZNA - INCOMING			
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Përbashkët Lokal Ministria e Administrimit të Përbashkët Lokal / Administration Ministry of Local Government Administration			
Data: 07.02.2017			
Llogaritja: -41- 020: 441			



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

01 Nr. 104-5333/2017
Kaçanik, 28.02.2017

Në bazë të nenit 57.1 dhe 57.2 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Raportit të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2016, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 28 Shkurt 2017, mori këtë:

**VENDIM
PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE
FINANCA PËR VITIN 2016**

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti, 01 Nr. 104-5333/2017 me tekstin e mëtejshëm, "Raport Pune i Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2016", i hartuar nga Komiteti për Politikë dhe Financa.
2. Raporti si në pikën 1. të këtij Vendimi, përmban pikësynimet e lidhje me realizimin e detyrave nga fushë veprimtarie që janë në kompetencë të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe nivelin e realizimit të tyre, lidhur me aktivitetin e zhvilluar për gjatë vitit 2016.
3. Raporti i KPF përmban gjithsej 9 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohet:

1. Komiteti për Politikë dhe Financa,
2. Kryetari i Komunës, dhe
3. Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Kaçanik
Skupština Opština
Municipal Assambly
- Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr. 104-533 /2017
Kaçanik, 20.02.2017

**RAPORT PUNE
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA,
për vitin. 2016**

Kaçanik, shkurt, 2017

Hyrje

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF-a) si trup i përhershëm punues i Kuvendit të Komunës, është formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës OI Nr.16-2234/14 me datë: 31.01.2014, në përbërje prej 7 anëtarëve, e cila përbërje ka pësuar ndryshime në vazhdimësi.

KPF në vitin 2016, kishte këtë përbërje:

1. Nhelal Gashi, Kryesues sipas funksionit
2. Sabedin Vishi, anëtar
3. Arbnora Kuka, anëtar
4. Tahir Caka, anëtar
5. Selim Reka, anëtar
6. Ruif Kasa, anëtar dhe
7. Avni Tafili, anëtar

Me Komitetin për Politikë dhe Financa, udhëheq Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Nhelal Gashi, sipas funksionit që e ka, Mandati i KPF-së është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës. Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa, reflekton përfaqësimin e etniteteve politike në Kuvendin e Komunës.

Përgjegjësitë:

Sipas nenit 52.2 të Ligjit Nr.03 L-040 - për Vetëqeverisje Lokale, KPF-a është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë edhe dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesëm, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore të tarifave dhe ngarkesave, planin vjetor të punës së auditivit të brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit të komunës gjatë vitit fiskal si dhe marrjen e raporteve nga kryetari i komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

Aktiviteti:

Sipas Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutit të Komunës, si dhe kompetencave të bartura nga Kuvendi i Komunës (kompetencës për ndërrimin e de stionit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore) KPF-a për gjatë periudhës raportuese është manduar që në suaza të kompetencave të veta t'i realizoj detyrat të cilat janë parashtruar.

Në këtë drejtim me angazhimin e vet, kjo trupë punuese është manduar të formuloj aso zgjidhje dhe t'i hulumtoj drejtimet më adekuatë për zhvillimin e komunës, e më këtë krijimin e kushteve për një jetë sa më të mirë të qytetarëve të komunës.

Veprimtarinë e vet e ka orientuar në fusha të ndryshme të cilat me legjislacionin në fuqi i janë lënë në kompetencë. Kjo veprimtari gjatë periudhës raportuese ishte mjaft e gjerë, paraqitën nevoja të ndryshme dhe ky komitet ka arritur në një masë t'i realizoj detyrat të cilat janë parashtruar, por assesi nuk është i kënaqur pasisë nevojat e shumta të qytetarëve të komunës na bëjnë që edhe më tutje të angazhohemi në zgjidhjen e çështjeve jetike.

Aktiviteti i Komitetit për Politikë dhe Financa është zhvilluar në tabele të rregullta mujore. Gjatë periudhës raportuese ky komitet ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje të rregullta. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kanë qënë të suksesshme dhe konstruktive.

Angazhimi i anëtarëve të KPF-a ka qenë në nivel të duhur. Presenca e anëtarëve të këtij komiteti ka qenë e rregullt, me përjashtim të ndonjë mungese eventuale të cilat kanë qenë shumë të arsyeshme. Në mbledhjet e KPF-së ka mbretëruar një frymë e punës dhe e bashkëpunimit në mes të subjekteve politike të përfaqësuara në këtë komitet. Çështjet që kanë qenë në interes të përgjithshëm të komunës kryesisht janë aprovuar njëzëri. Për të gjitha mbledhjet e KPF-a është mbajtur Procesverbal i cili ruhet me padanteri dhe është transparent në çdo kohë.

Në takimet e KPF-së janë shqyrtuar çështje të ndryshme në interes të komunës. Për çështjet e shqyrtuara në këtë komitet janë marrë edhe vendime adekuate, apo iu kanë rekomanduar organit vendimmarrës- Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe vendosje.

Për të gjitha çështjet të cilat është dashur të debatohet Kuvendi i Komunës në seancën e vet, kjo trupë punuese paraprkisht i ka shqyrtuar dhe e ka dhënë mendimin e vet. Në këtë drejtim ka shqyrtuar çështje për të cilat ia ka Rekomanduar Kuvendit të Komunës marrjen e vendimit adekuat.

Duke marrë parasysh natyrën e çështjeve të cilat janë parashtruar ka marrë gjithsej 09 Vendime brenda kompetencave të bartura nga Kuvendi i Komunës, për ndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për të cilat paraprkisht ka kërkuar mendimin profesional të drejtorisë përkatëse. Po ashtu në çdo mbledhje të KPF-së është aprovuar Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF-së.

Vlen për t'u theksuar se për çdo çështje që ka aprovuar ky komitet, është hartuar akti konform Vendimit të KPF-së.

Në takimet e kësaj trupe punuese kanë marrë pjesë: Kryetari i Komunës apo Nënkyetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive Komunale të cilët i kanë arsyetuar çështjet e propozuara sipas fushë veprimtarisë së tyre.

Ekzekutivi i komunës në mbledhjet e KPF-a ka dhënë edhe informacione tjera të nevojshme shtesë aty për aty, apo në mbledhjen vijuese në formë të shkruar për çështje të ndryshme dhe sipas kërkesave të KPF-a. Bashkëpunimi i KPF-a me stafin ndër ombëtarë gjatë periudhës raportuese ka qenë në nivelin e duhur. I gjithë materiali i mbledhjes i është dërguar OSBI, të cilët kryesisht i kanë monitoruar mbledhjet.

Mbledhjet e KPF-së janë mbajtur me dyer të hapura për medime publike, qytetarë të komunës, OJQ dhe për çdo të interesuar tjetër. Punën e kësaj trupe punuese e ka përcjellë edhe zyrtari për Informim, dhe për aktivitetin e zhvilluar të KPF-a ka bërë një përmbledhje të punimeve të çdo mbledhje dhe të njëjtin e ka plasuar në faqen zyrtare të komunës. Pjesa për mbledhje është publikuar çdo herë në faqen zyrtare dhe në tabelë të shpalljeve. Kjo tregon sesa ka qenë transparente kjo trupë punuese ndaj qytetarëve të komunës mediave, OJQ, etj. për takimet e KPF dhe aktivitetin e saj të zhvilluar përgjatë periudhës raportuese.

Çështjet e shqyrtuara:

Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë periudhës raportuese i ka shqyrtuar gjithsej : 64 pikë, pa e përfshirë Procesverbalin e mbledhjes së KPF, i cili ka qenë pikë e parë e rendit të punës në çdo mbledhje. Ky numër është edhe më i madh, mirëpo çështjet që kanë pasur natyrë të njëjtë, si: ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, pastaj, mbrojtja e vlerave të natyrës etj, janë përfshirë në kuadër të një pikë. Çështjet e shqyrtuara janë

materiale të përgatitura nga shërbimet përkatëse profesionale të komunës. Propozim Vendimet kanë qenë të natyrave të ndryshme. Në kuadër të propozim Vendimeve janë shqyrtuar çështje që kanë të bëjnë me: Aktet normative, Çështje buxhetore, Raporte dhe Programe të punës së ekzekutivit të komunës etj. Propozim vendime të ndryshme të shërbimeve përkatëse profesionale, dhe Çështje tjera më rëndësi për komunën. Në vazhdim do të i potencojmë çështjet të cilat kanë qenë në shqyrtim të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Aktet normative:

Në kuadër të kësaj sfere bëjnë pjesë aktet normative të cilat kanë qenë në shqyrtim të kësaj trupe punuese. Në këtë drejtim ky Komitet ka shqyrtuar akte normative të propozuara nga shërbimet përkatëse profesionale, dhe atë:

1. Propozim Rregullore për pagesën e tarifave, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale;
2. Propozim Rregullore për Hapjen e Kutive të Ankesave;
3. Propozim Rregullore për Ndryshim Plotësimin e Rregullores 01/Nr. 16-27322/12 -Për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, në territorin e komunës së Kaçanikut;
4. Propozim Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01-Nr.16-36731/2016, Për Pagesën e Tarifave, Ngarkesave administrative, Gjobave dhe Shërbimeve tjera Komunale e datës 15.02.2016;
5. Propozim Rregullore për vendosjen e Tatimit në Pronë në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2017;
6. Propozim Rregullore për kushtet dhe kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve; dhe
7. Propozim Statutin për Ndryshim Plotësimin e Statutit të Komunës(Shqyrtimi Fillestar).

Të çështja e ndryshimeve të Statutit të Komunës, KPI e ka parë të arsyeshme ndarjen e Sektorit të Kulturës nga Sektori i Arsimit, me qëllim të zhvillimit me të madh të aktiviteteve Kulturore e Sportive në këtë sektor, ndërkaq është ndier më i rezervuar të ndarjen e Zhvillimit Ekonomik nga Sektori i Financave dhe Ekonomisë, megjithatë drafti i propozuar është mbështetur si tërësi.

Kontribut të veçantë në çështjen e akteve normative, KPI-a ka dhënë edhe në Debate publike të organizuara me qytetarë. Mën të përmendet se KPI për gjatë vitit 2016, nën organizimin e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorive përkatëse Komunale janë mbajtur Debate Publike për Propozim Rregullore dhe për Draft Statutin e Komunës .

Çështjes së akteve normative në përgjithësi lloj trupë punuese lu ka shqyrtuar rëndësi të veçantë, i ka dhënë vërejtjet e saja dhe të njëjtat me Rekomandime të këtij komiteti i janë përcjellë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Draftet-Buxhetore dhe Raportet Financiare:

Si çdo herë kur janë shqyrtuar çështjet buxhetore edhe në vitin 2016, KPI-a i ka kushtuar rëndësi të veçantë, në këtë drejtim e ka aprovuar Qarkorja buxhetore- Procesi i Zhvillimit të Buxhetit të Komunës së Kaçanikut, për vitet, 2017-2019 dhe Kornizën afatmesme të shpenzimeve të komunës së Kaçanikut për vitet 2017-2019 dhe Buxhetit të Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2017 dhe vlerësimit për vitet 2018-2019..

Korniza afatmesme e shpenzimeve është dokument fillestar për hartimin e buxhetit të komunës. Vetëm për Draftin kornizë dhe dokumentet tjera përcjellëse, KPF-a ka debatuar gjerë e gjatë, e ka dhënë mendimin e vet, ndërkaq Draftin Kornizë ia ka Rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim. Vlen të përmendet së për qarkoret buxhetore dhe për draftin kornizë janë mbajtur edhe dëgjime publike me qytetarë, ku përpos organeve të administratës komunale kanë qenë të obliguar të marrin pjesë edhe anëtarët e KPF-a, të cilët në këtë drejtim e kanë dhënë kontributin e tyre.

Draft Buxheti i Komunës për vitin fiskal 2017 dhe kërkesat e projektuara për v.2018 dhe 2019;

Në këtë dokument, KPF-a i ka dhënë propozimet e veta për projektet që duhet të hyjnë në realizim në buxhetin afatmesëm të komunës për vitet: 2017-2019. Në këtë drejtim Komiteti për Politikë dhe Financa e ka aprovuar Buxhetin e komunës për vitin 2017 në shumë: 7.059.281 €, dhe Projektionet për vitet 2018-2019, në shumat buxhetore : 7.212.680+€ për vitin 2018 dhe: 7.359.4380 € për vitin 2019. I dhe në këtë plan afatmesëm buxhetor, KPF-a i ka futur synimet e veta për secilin veprimtarë konform Statutit të Komunës, dhe çdo herë duke iu dhënë prioritet Listës së Projekteve Kapitale. Në këtë drejtim ka aprovuar një Listë me 54 Projekte Kapitale, duke iu dhënë prioritet atyre projekteve që janë me të nevojshme dhe emergjente për komunitetet, ndërsa ka shprehur pakënaqësitë e tij në ndarje shumë të ulët të buxhetit të komunës, edhe pse buxheti për projekte kapitale në raport me atë të vitit 2016, është pak më i ngritur, mirëpo krahasuar me numrin e popullsisë së kësaj komune më regjistrimet e reja (vitit 2011) dhe nevojave të shumta të kësaj popullate, Granti Qeveritar për komunën tonë ende është i vogël. Duke marrë për bazë faktin se në buxhetin e ndarë për projekte kapitale, nuk mund të realizohen të gjitha projektet e aprovuara sepse disa nga projektet kanë hyrë në listë vetëm sa për t'u koduar, mirëpo gjithëherë është menduar në angazhimin e organeve të komunës, në nivelin qendror dhe në gjerë për gjetjen e donacioneve, me qëllim që projektet e aprovuara të realizohen. Një premtim i tillë është nga Ministria e Infrastrukturrës për donacione në 4 projekte kapitale. Kontributin e vet për çështjen e buxhetit të komunës, KPF-a e ka dhënë edhe në debatat e organizuara me qytetarë. Pas vlerësimit të thukët nga KPF-a, Projektbuxheti i Komunës për vitin fiskal 2017 dhe kërkesat e projektuara për vitin 2018-2019, i janë përcjellë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Raportet Financiare të aprovuara nga KPF-a:

- Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015.
- Raportin Financiar të Komunës së Kaçanikut, për periudhën: janar-mars, 2016.
- Raportin e realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën: janar-qeror, 2016.
- Raportin e realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën: janar-shtator 2016.
- Raporti Final i Auditivit të Përgjithshëm dhe Plani i Veprimit Ndërr me Pasqyrat vjetore financiare, për vitin e përfunduar me 31.12.2015.

Të çështja e raporteve financiare vlen të përmendet se KPF-a, në disa sektorë vlerëson se janë përmbushur objektivat konform planifikimit të hyrës veçake komunale, ndërsa në disa sektorë në raport me planifikimin ka qenë më pak i kënaqur dhe këto pakënaqësi kjo trupë punuese i ka shprehur tek ekzekutivi i komunës, ndërkaq KPF-a e vlerëson reduktimin e shpenzimeve në disa pozicione shpenzuese buxhetore që hyjnë në kuadër të kategorisë buxhetore të: Mallrave dhe shërbimeve, ndërkaq, si çdo vit tjetër, edhe në vitin 2016,

Komiteti për Politikë dhe Financa e vlerëson pozitivisht realizimin e të hyrave vetjake nga Tatimi në Pronë, i cili është promotor kryesor i realizimit të HVK.

Në Raportet Financiare, vlen të cekët se KPI-a ka kërkuar sqarime shtesë të shpenzimeve buxhetore në programe të caktuara buxhetore sa herë që janë shqyrtuar raportet financiare aty ku ka pasur paqartësi, ndërsa për çdo shpenzim që ka menduar se është i madh apo më pak i arsyeshëm në raport me nevojat të tjera, ka dhënë vërejtjet e tjera, ndërkaq i ka mbështetur rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditorit për zbatimin e rekomandimeve të paraqitura si në raportin e vitit 2015. Kur jemi të raportet financiare, vlen të përmendet se KPI-a ka kërkuar informacione për procedurat e udhëhequra të tenderimit, ndërkaq kanë sugjeruar Kryetarit të Komunës që Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse komunale të angazhohen lidhur me projektet për të cilat janë zhvilluar procedurat tenderuese, apo janë në plan për realizim në vitin 2016, të realizohen në afatet e përcaktuara kohore, ashtu siç e parasheh Ligji i Prokurimit Publik, në mënyrë që mos të ngelin mjetet në sullet buxhetor.

Propozim Vendimet për çështje financiare:

Propozim Vendimeve për çështje financiare, KPI-a iu ka kushtuar një rëndësi e veçantë, në këtë drejtim në pamundësi të realizimit të disa projekteve kapitale apo çështje të tjera, ka intervenuar në mjetet që nuk kanë arritur të realizohen sipas Listës së projekteve kapitale për vitin 2016, për t'i batur në ndonjë projekt tjetër kapital. Ndërkaq me qëllim që mos të ngelin mjetet buxhetore në sullet, KPI ka aprovuar Propozim Vendimi për rialokimin dhe transferimin e mjeteve të projekteve kapitale sipas buxhetit të vitit 2016. Nga kategoria e Subvencioneve dhe Transferove ka lejuar mjetet buxhetore për realizimin e projekteve të drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, dhe të Projekteve të drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, me një shpërndarje për projekte sipas Planit buxhetor të propozuar nga këto drejtori, ndërkaq masën drusore të konfiskuar ka vendosur me t'u ndarë shkollave.

Për çdo ndryshim buxhetor të propozuar, KPI-a ka kërkuar sqarime të nevojshme nga propozuesi pse ka arritur deri të ndryshimet buxhetore, e në veçanti ka kërkuar arsye të projektet kapitale që kanë qenë në listë për realizim e nuk janë realizuar në kohën e përcaktuar. Për të gjitha këto çështje, janë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet nga KPI-a dhe të njëjtat i janë Rekomanduar, Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratimin e tyre.

KPI, pos tjerash ka kërkuar në vazhdimësi sqarime të nevojshme nga ekzekutivi i komunës se deri ku kanë arritur realizimi i projekteve; Ndërtimit të Palestrës Sportive, dhe Ndërtimi i Stadiumit të qytetit "Besnik Begunca", dhe Ndërtimi i objektit shëndetësor të QKMF-projekt ky i cili është realizuar në vitin 2016.

Nga çështjet financiare ka aprovuar këto propozim vendime:

1. Propozim Vendimi për ndarjen e mjeteve për subvencione dhe transferove sipas buxhetit të komunës për vitin 2016;
2. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve të pushpënuara në buxhetin e komunës në vitin 2016;
3. Propozim Vendimi për Rishikimin e Buxhetit të Komunës, për vitin 2016;
4. Qarkorja buxhetore-Procesi i Zhvillimit të Buxhetit të Komunës së Kacaniikut, për vitet, 2017-2019;
5. Propozim Vendimi për destinimin e mjeteve financiare për realizimin e projekteve të drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, të parapara me buxhetin e vitit 2016.

6. Propozim Vendimi për Ndryshim plotësimin e Vendimit për destinimin e mjeteve financiare, për realizimin e projekteve të drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, të parapara me buxhetin e vitit 2016;
7. Propozim Vendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të komunës për vitin 2016;
8. Raporti Final i Auditimit të Përgjithshëm dhe Plan i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit, për vitin 2015;
9. Propozim Vendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të komunës për vitin 2016;

Vendimet:

Komiteti për Politike dhe Financa, në kuadër të fushë veprimtarisë së vet ka marrë 9 Vendime për ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore, në tokë mbërtimore të klasës së V dhe të VI, ndërkaq një Propozim Vendim të kësaj klase, ia ka adresuar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim, për shkak të sipërfaqes së madhe. Ndërkaq KPF-a sa herë që i adresohen propozim vendime të kësaj natyre, sugjeron ekzekutivit të komunës që të kenë kujdes për mos cenimin e Planeve zhvillimore të komunës në njërën anë dhe në anën tjetër, të ruhet tokat bujqësore, sepse fondi i tokave bujqësore në komunën e Kaçanikut është shumë i vogël.

Planet dhe Raportet e Punës dhe çështje të tjera:

Nga Planet dhe Raportet e Punës kjo trupë punuese ka vënë në shqyrtim:

1. Plan i Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2016;
2. Raporti i Punës së Komitetit për Politike dhe Financa, për vitin 2015;
3. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2015;
4. Plan i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2016;
5. Plan Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Kaçanikut për vitet: 2016-2018;
6. Plan Komunal i Menaxhimit të Mbeturimave për vitet: 2016-2021;
7. Planit komunal për Eficiency të Energjisë Elektrike, 2016-2021;
8. Plan i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017.

KPF-a i ka shqyrtuar në detaje të gjitha raportet dhe planet e punës të potencuar si më lartë, ka dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e veta dhe të njëjtat ia ka rekomanduar Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe aprovim, ndërkaq shpreson shumë në realizimin e Planeve Zhvillimore Afatmesme të Komunës të potencuar si më lartë të cilat ndikojnë në zhvillimin e komunës në sektore të caktuara, rritjen e efikasitetit në menaxhimin e mbeturimave, rritjen e efikasitetin për eficiency të energjisë elektrike dhe kursimin e mjeteve buxhetore me realizimin e planeve në fjalë, si dhe zhvillimin e sektorit të arsimit me realizimin e planit zhvillimor të arsimit.

Propozim Vendime të natyrave të ndryshme, me interes të përgjithshëm:

Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të disa pronave të paluajtshme, në Zonën e Kadastrave në Kaçanik të Vjetër, për Ndërtimin e Implantit për trajtimin e ujërave të zeza; Propozim Vendimet (14) për mbrojtjen e vlerës së natyrës; Propozim Vendimi për formimin e Grupit punues për hartimin e Planit të veprimit për proces transparent të buxhetit; Propozim Vendimi për Vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik, për zgjerimin e ndërtimit të Parkut të qytetit në Kaçanik; Propozim

Vendimi për Vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për krijimin e Zonës Ekonomike; Propozim Vendimi për Vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik, për ndërtimin e lapidarit të dëshmorit, Ismail Raka në Kaçanik; Propozim Vendimi për Vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për ndërtimin e trotuarit të rrugës " Sali Bajra"; Propozim Vendimi për Vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik, për ndërtimin e qendrës së mjekësisë familiare në Kaçanik të Vjetër; Propozim Vendime për dhënien e pronave të paluajtshëm të komunës në shfrytëzim.

Të gjitha këto Propozim Vendime janë të një rëndësie të veçantë, me interes të përgjithshëm të qytetarëve të komunës së Kaçanikut. Gjatë shqyrtimit këtyre çështjeve ju është kushtuar rëndësi e veçantë me vet faktin se disa nga to zgjidhin çështje jetike të popullatës së komunës tonë, si çështja e ndërtimit të implantit për menaxhimin ujërave të zeza, disa projekte ndikojnë në zhvillimin ekonomik të komunës, krijimin e të hyrave vetake komunale, duke krijuar mundësi të reja punësimit të qytetarëve të komunës tonë, krijimin e një ambienti më të bukur dhe të pastër etj. KPI për çdo paqartësi në këto çështje, ka kërkuar mendimi profesional i drejtorisë dhe të njëjtat pas shqyrtimit të hollësishëm të tyre, ia ka rekomanduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Propozim Vendimet me interes të personave fizik apo juridik janë:

Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 01520-1 në ZK në Kaçanik të Vjetër. Arë e Klasës 4 në pronësi të I krem Krraba; Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale Nr. 30-2 në ZK Elezaj. Arë e Klasës së 6, në pronësi të Ahmet Shorra; Propozim Vendimet për marrjen e vendimit paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të klasës I-4; Propozim Vendimi për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore te pronës së Avdush Hasip Dema; Propozim Vendimet (03) të DUKMM, për ndryshim plotësimin e Planit Rregullativ të komunës së Kaçanikut, për Zonën e I, dhe një pjesë të Zonës së II ; Propozim Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim arë shkurtër, për rregullimin e rrugut të karshëve.

Propozim Vendimi për Ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të Agim Gurit nga I. Nikaj; Propozimi për përkrahjen e pjesëmarrjes së qytetarëve me aftësi të kufizuara në jetën urbane të Kaçanikut.

I dhe të këto propozim Vendime, KPI i ka shqyrtuar në detaje të gjitha këto propozim vendime, disa nga to janë çështje janë të një natyre që për herë të parë i ka shqyrtuar KPI, si çështja e Propozim Vendimeve për marrjen e vendimit paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të klasës I-4. Në këtë drejtim KPI për kundër faktit se i ka aprovuar dhe ia ka kaluar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim, në këtë drejtim ka qenë pak më i rezervuar.

KPI gjatë periudhës raportuese ka shqyrtuar në formë të Informatave, këto Dokumentacione:

- Informatë për vlerësimin e performancës së komunës, në vitin 2015;
- Informatë për procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
- Informatë e DAK, për përtundimin e vitit sikollori 2015/2016;
- Informatë e DBPZHR, për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.

- Informatë e Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për çështjen e Banesës kolektive të banimit me lokale afar te, në afërsi të QKMF.
- Informatë për aktivitetin e Sektorit të Emergjencave.
- Informatë e DAK, për përfundimin e vitit shkollor 2015/2016.
- Informatë e DBZ/IRP, për fushatën, Korrje Sërjeve, në komunën e Kaçanikut.

Të çështja e arsimit, KPI ka sugjeruar DAK, të gjejë forma për uljen e mungesave të nxënësve dhe arsimtarëve në shkolla, ndërkaq ka identifikuar nevojën për ngritjen e cilësisë në arsim, përmirësimin e infrastrukturës së objekteve shkollore, etj.

Punët dhe detyrat e punës së KPI -a përgatiten nga një zyrtar i punësuar në Shërbimin për punë profesionale të kuvendit të Komunës. Me angazhimin e këtij zyrtari përgatiten mbledhjet e KPI -a, përgatitet materiali i nevojshëm, përpilohet Procesverbali i mbledhjes, Vendimet dhe shkresat tjera të dalura nga mbledhjet e kësaj trupe punuese dhe të njëjtat arkivohet për nevojat e Shërbimit Civil të Komunës. Të njëjtat punë ky zyrtar i kryen edhe për kuvendin e Komunës dhe për komitetin për komunitete.

Përfundim

Komiteti për Politikë dhe Financa është i vetëdijshëm se gjatë periudhës raportuese nuk ka qenë në gjendje të i realizoj të gjitha synimet e veta në drejtim të zgjedhjes së çështjeve si pasorë e së kaluarës dhe me një buxhet të limituar, por angazhimi i tyre jep shpresë se në një të ardhme të afërt dhe me një angazhim permanent në çeljen e donacioneve etj, gjendja do të përmirësohet. Komiteti për Politikë dhe Financa vlerëson të mirën dhe efikasë shërbimet e administratës komunale, respektivisht Qendrës për Shërbim të Qytetarëve, ndërkaq shpreson se do të arrihen rezultate në procesin e Legalizimit të objekteve pa leje- proces ky i cili ndikon edhe në rritjen e buxhetit nga të hyrat vetjake komunale. KPI është i mendimit se veprimtarinë e vet në të ardhmen do të ia orientoj në arritjen synimeve në realizimin e projekteve kapitale më rëndësi ekonomike, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Urban dhe në Planin Zhvillimor Komunal dhe realizimin e projekteve kapitale më prioritet sipas Listës së aprovuar për vitin 2017, ndërkaq vlerëson se ka nevojë të bëhet më tepër në këto segmente:

Zhvillimin ekonomik të komunës, Zbutjen e papunësisë, Ngritjen e mirëqenës sociale, Kujdesin primar shëndetësor, Ngritjen e cilësisë në arsim, Përmirësimin e infrastrukturës shkollore, Ndërtimin e objekteve shkollore të reja, ndërtimin e katit të dytë të SHMP "Feriz Çuri dhe Vëllezërit Çaka", Përfundimin e objekteve kulturore dhe sportive; Hallës së sporteve dhe të Stadiumit të qytetit, Ofrimin e Shërbimeve publike sa më cilësore, Nevojën për shtimin e subvencioneve dhe transferove në arsim, shëndetësi dhe bujqësi, Përmirësimin e infrastrukturës fizike (rrugë, ujësjellës dhe kanalizim), Mbrojtjen e ambientit, Zbatimin e rregullave të ndërtimit sipas standardeve, Çështjen e mbrojtjes së llyjeve, etj..Shqyrtimin e mundësive për rritjen e të HVK, si dhe Zhvillimin e Politikave për Çeljen e Donacioneve,

Shkurt, 2017.

Për Komitetin për Politikë dhe Financa,
Kryesuesi i Kuvendit, Xhehal Gashi